



VENDIM

Nr. 63, Datë 27.05.2016

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN
E “RREGULLORES SË PROCEDURAVE TË PARAQITJES DHE
MIRATIMIT TË PLANIT TË INVESTIMEVE NGA OPERATORËT E
TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE DHE TË LICENSUARVE QË MBARTIN DËTYRIMIN
E SHËRBIMIT PUBLIK”**

Ne mbështetje të neneve 16, 20 gërma “e”, 60 pika 9 dhe 75 pika 8 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenit 25 të Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.05.2016, mbasi shqyrtoi relacionin për “Rregulloren për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të licensuarit që mbartin detyrimin e shërbimit publik”, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullore së procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të licensuarit që mbartin detyrimin e shërbimit publik.”
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI